



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 80, datë 30.03.2022

**PËR
HEQJEN E NJOHJES DHE ÇREGJISTRIMIN E SHOQËRISË “VALIDIUS” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të nenit 33, pika 2, të Ligjit nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Shoqëria “Validius” sh.a., është e njohur dhe regjistruar nga Autoriteti me vendimin e Bordit nr. 252, datë 24.12.2019 si agjent i shoqërisë së brokerimit në tituj “VIE Finance A.E.P.E.Y S.A.” Ltd., me rregullator Komisionin e Tregut të Kapitalit të Greqisë.

Shoqëria “Validius” sh.a., me shkresën nr. 61/2 prot., datë 21.02.2022, ka informuar Autoritetin, se kontrata e lidhur me shoqërinë komisionere “VIE Finance A.E.P.E.Y S.A.” Ltd., përfundon më datë 28 shkurt 2022.

Shoqëria, informon se nuk ka për qëllim lidhjen e një kontrate me një shoqëri tjetër komisionere, dhe në këto kushte kërkon nga Autoriteti heqjen e njohjes dhe çregjistrimin e shoqërisë, si agjent i lidhur i brokerit të huaj.

Përsa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Heqjen e njohjes dhe çregjistrimin e shoqërisë “Validius” sh.a., për të vepruar si agjent i lidhur i brokerit të huaj.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**